



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Pranuar më: 24.03 2023		
Primljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-15008		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 24.03.2023

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ – të

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve Avancimin i SPORTIT në Komunën e Lipjanit

1. **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare (Klubet dhe shoqatat sportive) të Regjistruara në Republikën e Kosovës që Selin dhe adresën e Klubit apo Shoqatës e kanë në teritorin e Komunës së Lipjanit që programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e *Sportit dhe rekreacionit* të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në *Avancimin e SPORTIT në Komunën e Lipjanit*

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:

2.1. Klubet dhe Shoqatat sportive të cilat bëjnë gara zyrtare në Federatat përkatëse të licencuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

3. Organizatat jo- qeveritare mund të aplikojnë me një projekt përmes aktiviteteve si më poshtë:

✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin e aktiviteteve sportive dhe rekreacionit.

✓ Aktivitete që synojnë avancimin e politikave lokale dhe qeveritare në fushën e avancimit dhe promovimit të sportit

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 100,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 1,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 20,000.00 euro.

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 14.04.2023.

6. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti me një (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje, Periudha e zbatimit të projektit është për 12 muaj.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare (Klubet dhe Shoqatat sportive) me Selin dhe Adresën në Komunën e Lipjanit Republikën e Kosovës së paku *një vit* para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e { *Sportit dhe rekreacionit*. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas

legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (web faqen www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: {e-mail adresen agim.bylykbashi@rks-gov.net}

Vërejtje : rreth kriterëve, kushteve dhe shumës për aplikim shikoni Udhëzuesin të publikuar në web faqe

Anila Reçica Llugiqi

Drejtoreshë e DKRS-së

